



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat Sociale

Niveli i pagave në Kosovë 2012-2017



Hyrje

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon, për herë të dytë, pagën mesatare për:

- Sektorin Publik (Administrata),
- Sektorin Privat, dhe
- Ndërmarrjet publike

Ky raport është hartuar në bazë të kërkesës dhe nevojës nga shfrytëzuesit, përfshirë institucionet shtetërore dhe shfrytëzuesit e ndryshëm. Të dhënat e prezantuara në këtë raport, për pagën mesatare, janë të dhëna transparente, që do t'u ndihmojë vendimmarrësve në orientimin e politikave të tyre dhe në planifikimin e mënyrave më efektive në mbajtjen dhe motivimin e punonjësve

Niveli i pagës është një e dhënë shumë e rëndësishme, jo vetëm për organizatat, që e shfrytëzojnë si bazë për të bërë ndryshime (rritje/ulje), por njëherit është edhe tregues shumë i rëndësishëm për investitorët e rinj dhe çelës apo instrument tërheqës për të marrë kandidatë më të mirë.

Kur një organizatë është e përbërë nga njerëz të aftë dhe të motivuar nuk mungojnë edhe sukseset. Strukturat e pagave janë pjesë e domosdoshme e menaxhimit efektiv por janë faktorë bazë dhe shtytës të zhvillimeve. Për qasje më të lehtë të shfrytëzueseve, në këtë raport është dhënë paga mesatare bruto dhe neto.

Ky është raport me të dhëna për vitin 2017 derisa janë pasqyruar edhe për vitet 2012-2016 si qasje e vazhdueshme. ASK-ja planifikon që ti publikojë rregullisht të dhënat për pagën mesatare në nivelin më të ulët edhe sipas sektorëve ekonomikë.

Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së

Isa Krasniqi

Publikimin e përgatitën:

Avni Kastrati - Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale/Popullsisë

Naime Rexhepi, Shefe e Divizionit të Statistikave Sociale,

Bujar Hajrizi, Shef i Sektorit të Tregut të Punës,

Bedrije Demaj, Zyrtare e lartë e Tregut të Punës,

Muhamet Kastrati, Specialist i TI-së për RSB-së

Komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja, lidhur me këtë publikim, janë të mirëseardhura dhe mund të dërgohen në adresën elektronike: social@rks-gov.net

Shkurtesat

MAP – Ministria e Administratës Publike

RSB - Regjistri Statistikor i Bizneseve

ARBK – Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës

ATK - Administrata Tatimore e Kosovës

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës

BE - Bashkimi Evropian

NACE - Klasifikimi Statistikor i Aktiviteteve Ekonomike

ISCO - Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Profesioneve

Përmbajtja

	Faqe
Hyrje.....	2
Shkurtesat	4
Definicione	6
Paga bruto.....	6
Paga neto.....	6
Sektori publik.....	6
Sektori privat	6
Ndërmarrjet publike	6
Burimi i të dhënave dhe metodologjia.....	7
Sektori publik.....	7
Metoda e llogaritjes së pagës mesatare vjetore/sektori publik	7
Sektori privat	7
Burimi i të dhënave.....	7
Përfshin.....	7
Nuk përfshin	7
Burimet për azhurnimin e variablave të RSB-së janë.....	7
Ndërmarrjet publike	8
Burimi i të dhënave.....	8
Niveli i pagës mesatare në Kosovë.....	8
Paga mesatare sipas sektorëve në Kosovë.....	9
Paga mesatare në sektorin publik.....	9
Paga mesatare në sektorin privat	9
Paga mesatare te ndërmarrjet publike	10
Pagat mesatare bruto sipas sektorëve	10
Paga mesatare neto sipas sektorëve.....	11
Paga minimale në Kosovë.....	12

Definicione

Paga bruto

Të ardhurat bruto të punonjësve, që përfshin të ardhurat për punën dhe kohën e kaluar në punë, të ardhurat e tjera personale, të përcaktuara me ligj ose me marrëveshje kolektive (shtesat), ose kontratën e punës, në të cilën tatimi mbi të ardhurat personale është zbatuar. Ndryshe, paga bruto është shuma e përgjithshme e pagës pa tatim dhe pa kontributet e zbritura (pension/kursime pensionale, sigurime shëndetësore, etj.).

Paga neto

Pagat neto janë tatimi dhe kontributet e zbritura nga paga bruto.

Sektori publik

Të gjithë të punësuarit, të cilët marrin pagë nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës janë përfshirë në sektorin publik.

Sektori privat

Të gjithë të punësuarit, të cilët punojnë pranë ndërmarrjeve private (biznes privat), për të cilët ndërmarrjet paguajnë taksat dhe kontributet e tyre.

Ndërmarrjet publike

Ndërmarrjet publike përfshijnë të gjitha ndërmarrjet, që janë në pronësi publike, ose janë themeluar me fonde publike, ose sipas ligjit publik dhe nuk janë autoritete publike, ose pjesë të autoriteteve publike.

Burimi i të dhënave dhe metodologjia

Sektori publik

Burimi i të dhënave: të dhënat për sektorin publik janë nxjerrë nga Divizioni i Administrimit të Pagesave/lista e pagesave të pagave nga Ministria e Administratës Publike (MAP) për pagën bruto dhe neto. Numri i marrësve të pagave në sektorin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës (BKK) në dhjetor të vitit 2017 ishte gjithsej 81 466 persona¹.

Metoda e llogaritjes së pagës mesatare vjetore/sektori publik

Kalkulimi i pagës mesatare vjetore për sektorin publik është bërë sipas formulës:

$$\bar{x} = \frac{\sum_{i=1}^n x_i}{n} = \frac{x_1 + x_2 + \dots + x_n}{n}$$

- \bar{x} -prezanton simbolin për mesataren aritmetike të mostrës
- n - është numri total i vrojtimeve- elementeve
- x - prezanton vlerat individuale
- Σ - prezanton shumën e përgjithshme të vlerave.

Sektori privat

Burimi i të dhënave: të dhënat për sektorin privat janë nxjerrë nga Regjistri Statistikor i Bizneseve (RSB), që përmban të dhëna për të gjitha ndërmarrjet (publike dhe private), që ushtrojnë aktivitetin ekonomik brenda territorit të Kosovës.

Përfshin: të gjithë sektorët ekonomikë sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NACE Rev.2.

Nuk përfshin: Administratën Publike, Organizatat Jo-Fitimprurëse dhe Organizatat Ndërkombëtare.

Burimet për azhurnimin e variablave të RSB-së janë: Burimet administrative (informacionet nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë dhe nga Administrata Tatimore e Kosovës), si dhe burimet statistikore (Anketa për Azhurnimin e RSB-së, Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve dhe Anketat për Statistikat Afatshkurtra).

¹Në mesataren e pagave nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës (BKK), është përfshirë edhe fondi i kuadrove (shitesat).

Ndërmarrjet publike


Burimi i të dhënave: të dhënat për ndërmarrjet publike janë nxjerrë nga Regjistri Statistikor i Bizneseve (RSB), baza e njëjtë si te sektori privat.

Niveli i pagës mesatare në Kosovë

Në vitin 2012, paga mesatare bruto në Kosovë ishte 431 Euro, derisa në vitin 2017 ishte 520 Euro, një rritje prej 89 Eurosh ose 20.76%. Derisa, paga neto nga 384 Euro, sa ishte në vitin 2012, u rrit në 465 Euro në vitin 2017, me 81 Euro më shumë, ose 21.17%.

Tabela 1: Niveli i pagës mesatare bruto dhe neto, sipas viteve 2012-2017

Vitet	Paga mesatare		Sektori publik (BKK)		Sektori Privat		Ndërmarrjet publike	
	Bruto	Neto	Bruto	Neto	Bruto	Neto	Bruto	Neto
2012	431	384	407	353	367	333	518	465
2013	444	393	415	356	367	333	549	491
2014	482	430	465	408	358	326	624	556
2015	510	451	511	441	367	333	651	578
2016	519	457	525	449	371	337	660	586
2017	520	465	509	455	384	348	667	592




Grafiku 1: Paga mesatare bruto dhe neto sipas viteve 2012-2017

Paga mesatare sipas sektorëve në Kosovë

Paga mesatare në sektorin publik


Paga mesatare bruto në sektorin publik në vitin 2012 ishte 407 Euro, derisa në vitin 2017 ishte 509 Euro, duke u rritur për 102 Euro, ose 25.13%. Derisa, paga neto nga 353 Euro, sa ishte në vitin 2012, u rrit në 455 Euro, një rrije prej 102 Eurosh, ose 28.79%.



Grafiku 2: Niveli i pagës mesatare bruto dhe neto në sektorin publik, 2012-2017

Paga mesatare në sektorin privat


Paga mesatare bruto në sektorin privat, në vitin 2012 ishte 367 Euro, derisa në vitin 2017 ishte 384 Euro, që u rrit për 17 Euro, ose 4.63%. Derisa, paga neto nga 333 Euro, sa ishte në vitin 2012, u rrit në 348 Euro, me një rritje prej 15 Eurosh, ose 4.50%.



Grafiku 3: Niveli i pagës mesatare bruto dhe neto në sektorin privat, 2012-2017

Paga mesatare te ndërmarrjet publike


Paga mesatare bruto te ndërmarrjet publike, në vitin 2012 ishte 518 Euro, derisa në vitin 2017 ishte 667 Euro, që u rrit për 149 Euro, ose 28.76%. Derisa, paga neto nga 465 Euro, sa ishte në vitin 2012, u rrit në 592 Euro, një rritje prej 127 Eurosh, ose 27.31%.



Grafiku 4: Niveli i pagës masatare bruto dhe neto në ndërmarrjet publike, 2012-2017

Pagat mesatare bruto sipas sektorëve


Niveli i pagave më të larta në Kosovë ishte te ndërmarrjet publike. Në vitin 2012, te ndërmarrjet publike, paga mesatare bruto ishte 518 Euro, derisa në vitin 2017 arrinte në 667 Euro. Sektori publik, në vitin 2012, kishte një pagë mesatare bruto 407 Euro dhe në vitin 2017 një pagë mesatare 509 Euro. Sektori privat ishte sektori me pagën më të ulët mesatare bruto dhe me një rritje shumë të vogël. Ky sektor, në vitin 2012 kishte një pagë mesatare 367 Euro, derisa në vitin 2017 kishte një pagë mesatare 384 Euro.



Grafiku 5: Niveli i pagave mesatare bruto sipas sektorëve, 2012-2017


Paga mesatare neto sipas sektorëve

Te ndërmarrjet publike, paga mesatare neto, në vitin 2012, arrinte nivelin 465 Euro, derisa në vitin 2017 arrinte në 592 Euro. Sektori publik, në vitin 2012, kishte një pagë mesatare neto 353 Euro dhe në vitin 2017 një pagë mesatare neto prej 455 Eurosh. Sektori privat, në vitin 2012, kishte një pagë mesatare neto 333 Euro, derisa në vitin 2017 kishte një pagë mesatare 348 Euro.



Grafiku 6: Niveli i pagës mesatare neto sipas sektorëve, 2012-2017

Jo të gjithë sektorët patën rritje të shprehur të pagave nëpër vite. Në sektorin publik, paga bruto, për periudhën 2012-2017, u rrit për 102 euro. Te sektori privat, kishte vetëm një rritje prej 17 Eurosh, brenda periudhës në fjalë, nga 367 në 384 Euro. Te ndërmarrjet publike, pati rritje më të madhe me 149 Euro më shumë se viti 2012. Paralel u rritën edhe pagat neto.



Grafiku 7: Rritja e pagës mesatare bruto dhe neto sipas sektorëve, 2012 - 2017

Paga minimale në Kosovë

Norma e pagës minimale është paga më e ulët e lejuar, zakonisht e rregulluar përmes ligjeve shtetërore. Në Kosovë, aktualisht paga minimale është e kategorizuar në 130 Euro për të punësuarit deri në moshën 35-vjeçare dhe 170 Euro për të punësuarit mbi moshën 35-vjeçare.

Tabela 2: Raporti i pagës minimale me pagën mesatare bruto dhe neto në Kosovë, 2017

Paga minimale	Bruto (%)	Neto(%)
130	25.00	27.96
170	32.69	36.56

Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Programi i Statistikave Zyrtare, 2013/2017 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: **Departamentet prodhuese;** (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. **Departamentet mbështetëse;** (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. **Në kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Të punësuar janë gjithsej 147 punëtorë, prej tyre, 100 (68,0%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 47 (32,0%), Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 73,5% me shkollim universitar, 13,6 me shkollim të lartë, ndërsa 12,9% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njërive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomive Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Rregjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- **Fax::** +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>

ISBN 978-9951-22-502-1



9 789951 225021